			<p>ndryshuar, Pjesa IV, neni 194, pika 1, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe ndaj Prokurorit të Përgjithshëm. Në këtë kuadër, institucioni administron ankesat e paraqitura nga qytetarët dhe subjektet e ndryshme, si dhe kryen inspektime institucionale dhe tematike në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, i kushton rëndësi të veçantë realizimit të së drejtës për informim, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, sipas të cilit autoritetet publike kanë detyrimin të vënë në dispozicion të publikut informacionin që administrohet dhe disponohet nga institucioni në përputhje me kompetencat dhe funksionet e tij.</p> <p>Gjithashtu, veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të dhënat që lidhen me ushtrimin e kompetencave të tij pasqyrohen në mënyrë periodike në faqen zyrtare të institucionit, si dhe në materialet informuese</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>që publikohen në funksion të transparencës dhe llogaridhënies institucionale.</p> <p>Duke marrë në konsideratë natyrën e funksioneve të institucionit, sqarojmë se Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk është institucion me funksion statistikor dhe nuk përpunon apo prodhon statistika sipas kërkesave të individualizuara të subjekteve të interesuara. Megjithatë, të dhënat statistikore që grumbullohen dhe përpunohen në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së institucionit publikohen në mënyrë periodike në faqen zyrtare www.ild.al, si dhe në Buletinin informativ që publikohet çdo fillim muaji nga institucioni.</p> <p>Informacioni i kërkuar nga ana juaj lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në trajtimin e ankesave dhe procedurave hetimore; - kategoritë dhe burimet e ankesave të depozituara pranë institucionit; - procedimet disiplinore ndaj magjistratëve; - inspektimet institucionale dhe tematike të kryera nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, <p>gjendet i pasqyruar në mënyrë të detajuar në raportet vjetore të veprimtarisë së Inspektorit</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>të Lartë të Drejtësisë, të cilët janë të publikuar në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si më poshtë:</p> <p>Për vitin 2020- Të dhënat mbi numrin e ankesave, hetimeve disiplinore dhe kërkesave për procedim disiplinor gjenden të publikuara në raportin vjetor të ILD, konkretisht nga faqja 11 deri në faqen 15. https://ild.al/sq/2021/01/31/raport-per-vitin-2020-kuvend/</p> <p>Për vitin 2021- Të dhënat përkatëse gjenden në raportin vjetor të ILD nga faqja 12 deri në faqen 20. https://ild.al/sq/2022/05/19/raport-per-vitin-2021/</p> <p>Për vitin 2022- Të dhënat përkatëse gjenden në raportin vjetor të ILD nga faqja 11 deri në faqen 17. https://ild.al/sq/2023/05/05/raporti-i-punes-per-vitin-2022/</p> <p>Për vitin 2023- Të dhënat përkatëse gjenden në raportin vjetor të ILD nga faqja 13 deri në faqen 28. https://ild.al/sq/2024/05/10/raport-per-punen-e-zyres-se-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë-per-periudhen-01-01-2023-31-12-2023/</p> <p>Për vitin 2024- Të dhënat përkatëse gjenden në raportin vjetor të ILD nga faqja 13 deri në faqen 36. https://ild.al/sq/2025/04/15/raport-per-punen-e-zyres-se-inspektorit-te-larte-te-</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>drejtesise-per-periudhen-01-01-2024-31-12-2024/</p> <p>Sa i përket vitit 2025, të dhënat e kërkuara prej jush janë ende në proces përpunimi dhe do të publikohen sipas detyrimeve ligjore, ndërsa informacion i pjesshëm publikohet rast pas rasti në faqen zyrtare të institucionit www.ild.al.</p> <p>Gjithashtu, për vitin 2026 është miratuar plani i inspektimeve, i cili përfshin edhe inspektime vijuese në lidhje me caktimin e çështjeve në prokurori. Raportet e inspektimeve, përfshirë gjetjet, masat dhe rekomandimet përkatëse, janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit në linkun: https://ild.al/sq/legjislacion/raporte-inspektimesh-tematike/</p> <p>Në çdo rast, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbetet i gatshëm të vërë në dispozicion çdo informacion apo sqarim të mëtejshëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p>		
33	19.02.2026	Kërkesë për informacion mbi gjetjet e një Raporti nga M...C. (Media)	26.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, e regjistruar me nr. 560 prot., datë 19.02.2026, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në vijim të detyrimeve që burojnë nga parimi i transparencës dhe në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju vëmë në dijeni se:	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ju informon se kërkesa juaj është regjistruar me numër rendor 33 në regjistrin e posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit dhe me numrin hyrës në regjistër nr. 560 prot., datë 19.02.2026. Në këtë kuadër, në lidhje me këtë kërkesë për informacion, jeni të lutur të përdorni këtë numër regjistrimi në çdo korrespondencë në të ardhmen. Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron funksione kushtetuese dhe ligjore në fushën e verifikimit, hetimit disiplinor dhe kryerjen e inspektimeve ndaj gjykatave dhe prokurorive, duke garantuar respektimin e parimeve të ligjshmërisë, objektivitetit, paanshmërisë, proporcionalitetit dhe procesit të rregullt ligjor.</p> <p>Institucioni aktualisht funksionon në kushtet e një organike të paplotësuar, me 10 vakanca në njësinë inspektuese. Kjo situatë ndikon në kapacitetin për të trajtuar paralelisht një volum të konsiderueshëm çështjesh, në veçanti sa i përket fluksit të ankesave, hetimeve disiplinore dhe inspektimeve tematike apo institucionale. Për të garantuar funksionimin efektiv edhe në kushtet e kufizimeve të organikës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar me akte, mekanizma të brendshëm standardizues, dhe janë forcuar mekanizmat e kontrollit hierarkik, me qëllim ruajtjen e</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>cilësisë së vendimmarrjes, pavarësisht rritjes së ngarkesës së punës. Njëkohësisht, vijon realizimi i inspektimeve tematike dhe institucionale të planifikuara mbi bazën e analizës së riskut dhe indikatorëve të performancës sistemike, duke ruajtur funksionin parandalues dhe standardizues të këtij instrumenti.</p> <p>Paralelisht, institucioni ka ndjekur procedurat për plotësimin e strukturës përmes kërkesave për komandim të magjistratëve drejtuar Këshillave për pozicionet e “inspektor” dhe “këshilltar”, zhvillimit të procedurave të rekrutimit për inspektorë jomagjistratë dhe paraqitjes së propozimeve për përmirësime të kuadrit rregullator me qëllim rritjen e efektivitetit të proceseve të plotësimit të vendeve vakante.</p> <p>Gjendja e burimeve njerëzore dhe nevoja për përforsim të kapaciteteve janë reflektuar në dokumentacionet zyrtare të institucionit, në kuadër të programit të transparencës institucionale. Kjo çështje është trajtuar gjithashtu në kuadër të raportimeve periodike vjetore në Kuvendin e Shqipërisë, ku janë paraqitur në mënyrë të detajuar të dhënat mbi nivelin e plotësimit të organikës, ndikimin e vakancave në kuadër të trajtimit të çështjeve dhe masat e ndërmarra për adresimin e kësaj problematike. Në të njëjtën linjë, në komunikimet institucionale dhe takimet me</p>		
--	--	--	---	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>aktorë të shoqërisë civile, organizata monitoruese dhe partnerë të interesuar, është evidentuar në mënyrë të qartë nevoja për përforcimin e kapaciteteve inspektuese, si element thelbësor për garantimin e një funksionimi sa më efektiv të mekanizmit disiplinor. Ky angazhim në raportim dhe dialog institucional synon jo vetëm transparencën formale, por edhe krijimin e një kuadri bashkëpunimi dhe mirëkuptimi mbi sfidat strukturore që shoqërojnë ushtrimin e kompetencave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p> <p>Për sa i takon inspektimeve, efektiviteti i tyre nuk përcaktohet ekskluzivisht nga kapaciteti aktual numerik i strukturës, por nga cilësia e analizës juridike, respektimi i standardeve procedurale, pavarësia në ushtrimin e funksionit dhe integriteti institucional. Edhe në kushtet aktuale të strukturës së paplotësuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar ushtrimin e kompetencave të tij, duke realizuar inspektime dhe duke iniciuar procedime disiplinore në përputhje me kompetencën kushtetuese.</p> <p>Në analizë të ecurisë së veprimtarisë inspektuese rezulton se, edhe në kushtet e një strukture të paplotësuar dhe me vakanca të vazhdueshme në trupën inspektuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të pandërprerë kompetencat e tij kushtetuese, duke shënuar</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>rritje progresive të inspektimeve dhe procedimeve disiplinore nga viti 2020 deri më sot, me një total prej:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 30 inspektimesh tematike dhe institucionale; - shqyrtimin e mbi 6600 ankesave; - hetimin disiplinor ndaj 145 subjekteve të hetimit disiplinor; - paraqitjen e kërkesave për procedim disiplinor për 53 magjistratë. <p>Në këtë drejtim, fakti që gjetjet dhe qëndrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë konfirmuar në mënyrë të vazhdueshme nga organet kompetente, përfshirë Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit, përbëjnë tregues të funksionimit të mekanizmit disiplinor dhe të konsolidimit të standardeve profesionale në sistem.</p> <p>Që prej krijimit si institucion e në vijimësi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zbaton në mënyrë rigoroze kuadrin ligjor për menaxhimin buxhetor dhe menaxhimin financiar e kontrollin, duke respektuar parimet e menaxhimit me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi të burimeve financiare. Planifikimi i fondeve lidhet drejtpërsëdrejti me aktivitetet dhe masat e planit të veprimit të dokumenteve strategjike, si plani strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, etj. Në këtë kuadër, edhe fondet që lidhen me shpenzimet operative, detajohen në funksion të</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				përbushjes së objektivave strategjike. Realizimi i fondeve buxhetore monitorohet rregullisht përmes raporteve periodike, të cilat janë vlerësuar për performancën dhe transparencën e tyre nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Ministria e Financave.		
34	20.02.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi z. B. Ç.	04.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur përmes postës elektronike dhe të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 599 prot., datë 20.02.2026, përmes së cilës kërkonti informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Sikurse jeni njoftuar dhe me shkresën nr. 1841/1 datë 17.06.2025, bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kritereve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret,</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.		
35	23.02.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi znj. F. K.	03.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 610 prot., datë 23.02.2026, përmes së cilës kërkonte informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj me nr. 1533/2 prot., datë 05.12.2025 ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>	Përfunduar	Nuk ka
36	23.02.2026	Kërkesë për marrje dokumentacioni mbi një proces që është ende në shqyrtim nga shtetasi z. F. B.	06.03.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, nëpërmjet të cilës kërkohet informacion për aktet e dosjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me procedurat për kërkesën me objekt “Deklarimin e mbarimit të mandatit të magjistratit, të gjyqtarës XXX, përfunduar nga ky Këshill me vendimin datë 30.01.2026”, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>konfirmon marrjen e saj nëpërmjet shërbimit postar në datën 23.02.2026.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon se kërkesa juaj është regjistruar me numër rendor 36 në regjistrin e posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit dhe me numrin hyrës në regjistër nr. 612 prot., datë 23.02.2026. Në këtë kuadër, në lidhje me këtë kërkesë për informacion jeni të lutur të përdorni këtë numër regjistrimi në çdo korrespondencë në të ardhmen.</p> <p>Në mbështetje të nenit 147, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 3, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikës 4, shkronja “d” të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe nenit 64, shkronja “b” dhe nenit 66 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi përgjegjës kushtetues, ka iniciuar, si dhe ka zhvilluar procedurën e verifikimit mbi ekzistencën e kushteve ndaluese për magistraten XXX me detyrë</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>gjqtare në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Gjithashtu, në lidhje me këtë magjistrate, në datë 03.02.2026, z. Klodian Kurushi, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe njëkohësisht Kryetar i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën, me objekt “Fillimin e hetimit për shkelje disiplinore ndaj magistrates XXX, gjqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë në analizë të ankesës së paraqitur nga ana e ankuesit, si dhe dokumentacionit shoqërues të saj, paraprakisht vlerëson se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është përcjellë në rrugë zyrtare dhe me vendim pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë praktika administrative (dokumentacioni) që ka prodhuar, apo administruar në këtë rast ky institucion në kuadër të zhvillimit të procesit të dekriminalizimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, apo verifikimit të kushteve të papajtueshmërisë/pazgjidhshmërisë sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Në këtë rast, kjo</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>ankesë është përcjellë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 532/1 prot., datë 03.02.2026, të firmosur nga ana e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Rusi, si dhe është shoqëruar vetëm me disa akte të veçanta të njëjësuar me origjinalin në lidhje me zhvillimin e këtij procedimi administrativ.</p> <p>Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, parapakisht vlerëson se kërkesa juaj për vënien në dispozicion të kopjes së njëjësuar me origjinalin të të gjitha akteve të dosjes administrative të Këshillit të Lartë Gjyqësor të krijuar në lidhje me verifikimin e figurës, apo deklarimit të mbarimit të mandatit të magistratit për gjyqtaren XXX, të paraqitura nga palët, apo të krijuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet t'i drejtohet dhe duhet të trajtohet vetëm nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si institucioni përgjegjës, i cili ka prodhuar dhe administron të gjithë dokumentacionin mbi zhvillimin e procedimit administrativ të zhvilluar nga ana e tij në kuadër të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe verifikimit të kushteve të papajtueshmërisë/pazgjidhshmërisë sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>Në të njëjtën kohë, në lidhje me aktet e veçanta që insitucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur nga ana e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat përmbajnë të dhëna mbi rrethana të faktit që mund të jenë në proces verifikimi, analize apo vlerësimi në kuadër të zhvillimit të një procesi tjetër inspektimi, apo hetimi disiplinor ndaj magistrates XXX, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, parapakisht vlerëson se përgjatë zhvillimit të procedurave administrative ILD i kushton një rëndësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë sipas kërkesave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të ndryshuar, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e integritetit dhe figurën e subjekteve të procedurës administrative, mbrojtjes së interesave ligjore të personave të tretë, si dhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cenojë funksionimin në vazhdim dhe qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p> <p>Shqyrtimi i ankesave dhe hetimi disiplinor i nënshtrohet rregullave dhe parimeve të sanksionuara në nenin 100 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Parimet e procedimit disiplinor janë të harmonizuara edhe me praktikën ndërkombëtare të mekanizmave të Këshillit të Evropës, siç është edhe praktika e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), organ këshillimor i Këshillit të Evropës për çështje që lidhen me pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencën e gjyqtarëve. Në disa nga Opinionet e tij ka theksuar se hetimi disiplinor është konfidencial. Konfidencialiteti i veprimeve hetimore fillon me shqyrtimin fillestar apo veprimet paraprake hetimore për sjellje/shkelje të dyshuara nga gjyqtarët duhet të kryhen në mënyrë konfidenciale për të mbrojtur integritetin e procesit dhe reputacionin e gjyqtarit nëse akuzat rezultojnë të pabazuara.</p> <p>Në mbështetje të parashikimeve të nenit 5, 6, 8, 12 të ligjit nr. 44/2016 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 100, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 17, pika 2, shkronja “c” dhe “ç” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e funksioneve të tij udhëhiqet dhe synon zbatimin e përshtatshëm, proporcional dhe në mënyrë të balancuar të parimit të transparencës dhe të drejtës për informim, në raport me atë të konfidencialitetit, të drejtës</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>për jetë private dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.</p> <p>Çdo veprim administrativ i ndërmarrë nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë synon të jetë i nevojshëm dhe sa më i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj, duke mos cenuar të drejtat apo interesat legjitim të palëve në një procedurë administrative, si dhe në përpjesëtim me nevojën të cilën e ka diktuar atë. Në mbështetje të nenit 119, pika 4 dhe nenit 129 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 42, 45, 78 të ligjit nr. 44/2016 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetëm palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen aktet dhe dokumentacionin që përbëjnë dosjen administrative/hetimore.</p> <p>Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 5, 6, 8, 12, 42, 45, 78, të ligjit nr. 44/2016 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; nenit 119, pika 4, nenit 100, pika 2 dhe nenit 129, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 117, pika 2, shkronja “c” dhe “ç” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke vlerësuar se ju nuk jeni palë në procedurën administrative, as në cilësinë e ankuesit dhe as në cilësinë e magjistratit ndaj</p>		
--	--	--	---	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				të cilit është paraqitur ankesa, informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk mund t'ju vihet në dispozicion në këtë moment.		
37	24.02.2026	Kërkesë për informacion nëse ka ankesë ndaj magjistratit F.N., të paraqitur nga. “Media L...”	06.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të mbërritur nëpërmjet postës elektronike pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me anë të së cilës kërkonte informacion mbi ecurinë e një ankese ndaj gjyqtarit F.N., ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon se kërkesa juaj është regjistruar me numër rendor 37 në regjistrin e posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit dhe me numrin hyrës në regjistër nr. 633 prot., datë 24.03.2026. Në lidhje me këtë kërkesë për informacion jeni të lutur të përdorni këtë numër regjistrimi në çdo korrespondencë në të ardhmen.</p> <p>Referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 44/2016 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me fazën në të cilën ndodhet ankesa, si dhe me çdo vendim pas fazës së verifikimit. Në këtë rast rezulton që “LAPSI.al” nuk është palë në procedurën administrative, as si ankues dhe as si magjistrat, e për rrjedhojë nuk mund të</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>informohet mbi ecurinë e ankesës ndaj gjyqtarit F.N.,</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë përgjatë zhvillimit të procedurave administrative i kushton një rëndësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë sipas kërkesave të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e integritetit dhe figurën e subjekteve të procedurës administrative, mbrojtjes së interesave ligjore të personave të tretë, si dhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cenojë funksionimin në vazhdim dhe qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>Sa i përket afateve procedurale të shqyrtimit paraprak dhe hetimit disiplinor të ankesave, ju vëmë në dijeni se procesi i trajtimit të ankesave, përfshirë shqyrtimin fillestar, verifikimin dhe hetimin disiplinor, realizohet në përputhje me parashikimet e Pjesës V, Kreu II, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke garantuar transparencë dhe efikasitet në përpunimin e çështjeve të referuara.</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.</p>		
38	24.02.2026	<p>Kërkesë për informacion nëse ka ankesë ndaj magjistratit M.SH., të paraqitur nga. “Media L...”</p>	06.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të mbërritur nëpërmjet postës elektronike pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me anë të së cilës kërkonte informacion mbi ecurinë e një ankese ndaj gjyqtarës M.Sh., ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon se kërkesa juaj është regjistruar me numër rendor 37 në regjistrin e posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit dhe me numrin hyrës në regjistër nr. 633 prot., datë 24.03.2026. Në lidhje me këtë kërkesë për informacion jeni të lutur të përdorni këtë numër regjistrimi në çdo korrespondencë në të ardhmen.</p> <p>Referuar ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 44/2016 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, palët në një</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me fazën në të cilën ndodhet ankesa, si dhe me çdo vendim pas fazës së verifikimit. Në këtë rast rezulton që “LAPSI.al” nuk është palë në procedurën administrative, as si ankues dhe as si magjistrat, e për rrjedhojë nuk mund të informohet mbi ecurinë e ankesës ndaj gjyqtarës M.Sh.,.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë përgjatë zhvillimit të procedurave administrative i kushton një rëndësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë sipas kërkesave të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e integritetit dhe figurën e subjekteve të procedurës administrative, mbrojtjes së interesave ligjore të personave të tretë, si dhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cenohet funksionimin në vazhdim dhe qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> <p>Sa i përket afateve procedurale të shqyrtimit paraprak dhe hetimit disiplinor të ankesave, ju vëmë në dijeni se procesi i trajtimit të ankesave, përfshirë shqyrtimin fillestar, verifikimin dhe hetimin disiplinor, realizohet në përputhje me parashikimet e Pjesës V, Kreu</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>II, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke garantuar transparencë dhe efikasitet në përpunimin e çështjeve të referuara.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.</p>		
39	24.02.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi z. D. L.	04.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 634 prot., datë 24.02.2026, përmes së cilës kërkonte informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>shqyrtimin e çdo ankese, sipas kriterëve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>		
40	25.02.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi z. P. T.	04.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 642 prot., datë 25.02.2026, përmes së cilës kërkonte informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kriterëve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.		
41	26.02.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi znj. M. Xh.	04.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 651 prot., datë 26.02.2026, përmes së cilës kërkon informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankesë, sipas kriterëve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.		
42	27.02.2026	Kërkesë për marrje dokumentacioni mbi një proces që është ende në shqyrtim nga shtetasi z. S. B.	06.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, nëpërmjet të cilës kërkohet informacion për aktet e dosjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me procedurat për kërkesën me objekt “Deklarimin e mbarimit të mandatit të magjistratit, të gjyqtarës XXX, përfunduar nga ky Këshill me vendimin datë 30.01.2026”, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konfirmon marrjen e saj nëpërmjet shërbimit postar në datën 27.02.2026.</p> <p>Në mbështetje të nenit 147, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 3, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikës 4, shkronja “d” të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe nenit 64, shkronja “b” dhe nenit 66 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi përgjegjës kushtetues, ka iniciuar, si dhe ka zhvilluar procedurën e verifikimit mbi ekzistencën e kushteve</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>ndaluese për magistraten XXX me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Gjithashtu, në lidhje me këtë magjistrate, në datë 03.02.2026, z. Klodian Kurushi, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe njëkohësisht Kryetar i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën, me objekt “Fillimin e hetimit për shkelje disiplinore ndaj magistrates XXX, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë në analizë të ankesës së paraqitur nga ana e ankuesit, si dhe dokumentacionit shoqërues të saj, paraprakisht vlerëson se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është përcjellë në rrugë zyrtare dhe me vendim pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë praktika administrative (dokumentacioni) që ka prodhuar, apo administruar në këtë rast ky institucion në kuadër të zhvillimit të procesit të dekriminalizimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, apo verifikimit të kushteve të papajtueshmërisë/pazgjidhshmërisë sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>Shqipërisë” i ndryshuar. Në këtë rast, kjo ankesë është përcjellë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 532/1 prot., datë 03.02.2026, të firmosur nga ana e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Rusi, si dhe është shoqëruar vetëm me disa akte të veçanta të njehsuara me origjinalin në lidhje me zhvillimin e këtij procedimi administrativ.</p> <p>Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, paraprakisht vlerëson se kërkesa juaj për vënien në dispozicion të kopjes së njehsuar me origjinalin të të gjitha akteve të dosjes administrative të Këshillit të Lartë Gjyqësor të krijuar në lidhje me verifikimin e figurës, apo deklarimit të mbarimit të mandatit të magistratit për gjyqtaren XXX, të paraqitura nga palët, apo të krijuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet t’i drejtohet dhe duhet të trajtohet vetëm nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si institucioni përgjegjës, i cili ka prodhuar dhe administron të gjithë dokumentacionin mbi zhvillimin e procedimit administrativ të zhvilluar nga ana e tij në kuadër të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe verifikimit të kushteve të papajtueshmërisë/pazgjdhshmërisë sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>Në të njëjtën kohë, në lidhje me aktet e veçanta që institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur nga ana e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat përmbajnë të dhëna mbi rrethana të faktit që mund të jenë në proces verifikimi, analize apo vlerësimi në kuadër të zhvillimit të një procesi tjetër inspektimi, apo hetimi disiplinor ndaj magistrates XXX, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, paraprakisht vlerëson se përgjatë zhvillimit të procedurave administrative ILD i kushton një rëndësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë sipas kërkesave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të ndryshuar, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e integritetit dhe figurën e subjekteve të procedurës administrative, mbrojtjes së interesave ligjore të personave të tretë, si dhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cenohet funksionimin në vazhdim dhe qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p> <p>Shqyrtimi i ankesave dhe hetimi disiplinor i nënshtrohet rregullave dhe parimeve të sanksionuara në nenin 100 e vijues të ligjit nr.</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Parimet e procedimit disiplinor janë të harmonizuara edhe me praktikën ndërkombëtare të mekanizmave të Këshillit të Evropës, siç është edhe praktika e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), organ këshillimor i Këshillit të Evropës për çështje që lidhen me pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencën e gjyqtarëve. Në disa nga Opinionet e tij ka theksuar se hetimi disiplinor është konfidencial. Konfidencialiteti i veprimeve hetimore fillon me shqyrtimin fillestar apo veprimet paraprake hetimore për sjellje/shkelje të dyshuara nga gjyqtarët duhet të kryhen në mënyrë konfidenciale për të mbrojtur integritetin e procesit dhe reputacionin e gjyqtarit nëse akuzat rezultojnë të pabazuara.</p> <p>Në mbështetje të parashikimeve të nenit 5, 6, 8, 12 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 100, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 17, pika 2, shkronja “c” dhe “ç” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e funksioneve të tij udhëhiqet dhe synon zbatimin e përshtatshëm, proporcional dhe në mënyrë të balancuar të parimit të transparencës dhe të drejtës për informim, në</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>raport me atë të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.</p> <p>Çdo veprim administrativ i ndërmarrë nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë synon të jetë i nevojshëm dhe sa më i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj, duke mos cenuar të drejtat apo interesat legjitime të palëve në një procedurë administrative, si dhe në përpjesëtim me nevojën të cilën e ka diktuar atë. Në mbështetje të nenit 119, pika 4 dhe nenit 129 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 42, 45, 78 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetëm palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me aktet dhe dokumentacionin që përbëjnë dosjen administrative/hetimore.</p> <p>Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 5, 6, 8, 12, 42, 45, 78, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; nenit 119, pika 4, nenit 100, pika 2 dhe nenit 129, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 17, pika 2, shkronja “c” dhe “ç” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar duke vlerësuar se ju nuk jeni palë në procedurën administrative, as</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				në cilësinë e ankuesit dhe as në cilësinë e magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa, informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk mund t'ju vihet në dispozicion në këtë moment.		
43	27.02.2026	Kërkesë për marrje dokumentacioni mbi një proces që është ende në shqyrtim nga shtetasi z. J. M.	06.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, nëpërmjet të cilës kërkohet informacion për aktet e dosjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me procedurat për kërkesën me objekt “Deklarimin e mbarimit të mandatit të magjistratit, të gjyqtarës XXX, përfunduar nga ky Këshill me vendimin datë 30.01.2026”, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konfirmon marrjen e saj nëpërmjet shërbimit postar në datën 27.02.2026.</p> <p>Në mbështetje të nenit 147, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 3, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikës 4, shkronja “d” të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe nenit 64, shkronja “b” dhe nenit 66 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi përgjegjës kushtetues, ka</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>iniciuar, si dhe ka zhvilluar procedurën e verifikimit mbi ekzistencën e kushteve ndaluese për magistraten XXX me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Gjithashtu, në lidhje me këtë magjistrate, në datë 03.02.2026, z. Klodian Kurushi, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe njëkohësisht Kryetar i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën, me objekt “Fillimin e hetimit për shkelje disiplinore ndaj magistrates XXX, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë në analizë të ankesës së paraqitur nga ana e ankuesit, si dhe dokumentacionit shoqërues të saj, paraprakisht vlerëson se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është përcjellë në rrugë zyrtare dhe me vendim pranë institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë praktika administrative (dokumentacioni) që ka prodhuar, apo administruar në këtë rast ky institucion në kuadër të zhvillimit të procesit të dekriminalizimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, apo verifikimit të kushteve të papajtueshmërisë/pazgjdhshmërisë sipas</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Në këtë rast, kjo ankesë është përcjellë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 532/1 prot., datë 03.02.2026, të firmosur nga ana e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Rusi, si dhe është shoqëruar vetëm me disa akte të veçanta të njehsuara me origjinalin në lidhje me zhvillimin e këtij procedimi administrativ.</p> <p>Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, paraprakisht vlerëson se kërkesa juaj për vënien në dispozicion të kopjes së njehsuar me origjinalin të të gjitha akteve të dosjes administrative të Këshillit të Lartë Gjyqësor të krijuar në lidhje me verifikimin e figurës, apo deklarimit të mbarimit të mandatit të magjistratit për gjyqtaren XXX, të paraqitura nga palët, apo të krijuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet t’i drejtohet dhe duhet të trajtohet vetëm nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si institucioni përgjegjës, i cili ka prodhuar dhe administron të gjithë dokumentacionin mbi zhvillimin e procedimit administrativ të zhvilluar nga ana e tij në kuadër të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe verifikimit të kushteve të papajtueshmërisë/pazgjidhshmërisë sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>gjqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p> <p>Në të njëjtën kohë, në lidhje me aktet e veçanta që institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur nga ana e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat përmbajnë të dhëna mbi rrethana të faktit që mund të jenë në proces verifikimi, analize apo vlerësimi në kuadër të zhvillimit të një procesi tjetër inspektimi, apo hetimi disiplinor ndaj magistrates XXX, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, paraprakisht vlerëson se përgjatë zhvillimit të procedurave administrative ILD i kushton një rëndësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë sipas kërkesave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të ndryshuar, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e integritetit dhe figurën e subjekteve të procedurës administrative, mbrojtjes së interesave ligjore të personave të tretë, si dhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cenohet funksionimin në vazhdim dhe qëllimin e veprimtarisë së tij, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>Shqyrtimi i ankesave dhe hetimi disiplinor i nënshtrohet rregullave dhe parimeve të sanksionuara në nenin 100 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Parimet e procedimit disiplinor janë të harmonizuara edhe me praktikën ndërkombëtare të mekanizmave të Këshillit të Evropës, siç është edhe praktika e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), organ këshillimor i Këshillit të Evropës për çështje që lidhen me pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencën e gjyqtarëve. Në disa nga Opinionet e tij ka theksuar se hetimi disiplinor është konfidencial. Konfidencialiteti i veprimeve hetimore fillon me shqyrtimin fillestar apo veprimet paraprake hetimore për sjellje/shkelje të dyshuara nga gjyqtarët duhet të kryhen në mënyrë konfidenciale për të mbrojtur integritetin e procesit dhe reputacionin e gjyqtarit nëse akuzat rezultojnë të pabazuara.</p> <p>Në mbështetje të parashikimeve të nenit 5, 6, 8, 12 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 100, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 17, pika 2, shkronja “c” dhe “ç” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e funksioneve të tij udhëhiqet dhe</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>synon zbatimin e përshtatshëm, proporcional dhe në mënyrë të balancuar të parimit të transparencës dhe të drejtës për informim, në raport me atë të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.</p> <p>Çdo veprim administrativ i ndërmarrë nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë synon të jetë i nevojshëm dhe sa më i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj, duke mos cenuar të drejtat apo interesat legjitime të palëve në një procedurë administrative, si dhe në përpjesëtim me nevojën të cilën e ka diktuar atë. Në mbështetje të nenit 119, pika 4 dhe nenit 129 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 42, 45, 78 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vetëm palët në një procedurë administrative kanë të drejtë të njihen me aktet dhe dokumentacionin që përbëjnë dosjen administrative/hetimore.</p> <p>Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 5, 6, 8, 12, 42, 45, 78, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; nenit 119, pika 4, nenit 100, pika 2 dhe nenit 129, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 17, pika 2, shkronja “c” dhe</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>“ç” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar duke vlerësuar se ju nuk jeni palë në procedurën administrative, as në cilësinë e ankuesit dhe as në cilësinë e magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa, informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk mund t’ju vihet në dispozicion në këtë moment.</p>		
44	02.03.2026	Kërkesë për takim dhe informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi znj. A.K	11.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 645/2 prot., datë 02.03.2026, përmes së cilës kërkonti informacion lidhur me fazën e ankesave tuaja si dhe takim me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesat tuaja janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kriterëve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p> <p>Për sa i përket kërkesës tuaj për takim, ju mund të paraqiteni pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, çdo ditë nga ora 09:00, deri në</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>orën 14:00, për t'u takuar me përfaqësues të Sektorit të Ndhmës dhe Koordinimit të Informacionit në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>		
45	02.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi znj. I. J.	11.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 708 prot., datë 02.03.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kriterëve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar</p>		
46	04.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi znj. A. S.	11.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyren e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 724 prot., datë 04.03.2026, përmes së cilës kërkon informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kritereve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

47	10.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi z. I. K.	13.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 798 prot., datë 10.03.2026, përmes së cilës kërkonti informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj me nr. 3664 prot., datë 23.12.2025 është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>	Përfunduar	Nuk ka
48	10.03.2026	Kërkesë për takim dhe informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi z. E. O.	17.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 799 prot., datë 10.03.2026, përmes së cilës kërkonti takim me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj nr. 553 prot., datë 18.02.2026 ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Në takimin e zhvilluar me përfaqësues të Sektorit të Ndihmës dhe Koordinimit të Informacionit, më datë 23.02.2026, keni marrë</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>informacion të plotë dhe të detajuar rreth kompetencave, afateve dhe proceset nëpërmjet të cilave kalon shqyrtimi i ankesave nga momenti i depozitimit, deri në daljen me vendim nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, ju mund të paraqiteni sërish pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, çdo ditë nga ora 09:00, deri në orën 14:00, për t'u takuar me përfaqësues të Sektorit të Ndihmës dhe Koordinimit të Informacionit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.</p>		
49	12.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë e ankesës të paraqitur nga shtetasi z. Xh. A.	13.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 842 prot., datë 12.03.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesa juaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj me nr. 695 prot., datë 02.03.2026 është në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.		
50	12.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin dhe afatet e ankesës të paraqitur nga shtetasi z. M.Sh	17.03.2026	<p>Në vijim të kërkesës suaj nëpërmjet të cilës kërkohet informacion lidhur me emrin e inspektorit që ka në shqyrtim ankesën e paraqitur nga ana juaj me nr.764 prot., datë 06.03.2026, Inspektori i Lartë i Drejtësisë konfirmon marrjen e saj në datën 12.03.2026, si dhe ju informon se kërkesa juaj është regjistruar me numrin hyrës në regjistër nr. 764/4 prot., datë 12.03.2026. Në këtë kuadër, jeni të lutur të përdorni këtë numër në çdo korrespondencë në të ardhmen.</p> <p>Prioritet i punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është shqyrtimi dhe vlerësimi me seriozitet i të gjitha pretendimeve të paraqitura nga ana e personave fizik dhe juridik lidhur me veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratëve brenda apo jashtë funksionit. Objekt i këtij shqyrtimi janë dhe rastet e referuara nga ana juaj dhe ju do të njoftoheni për çdo vendim që do të merret në lidhje me ankesën tuaj.</p> <p>Për sa i përket kërkesës tuaj me anë të së cilës kërkoni informacion lidhur me inspektorin përgjegjës, i cili ka në trajtim ankesën e</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>paraqitur prej jush, ju bëjmë me dije se Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë organizohet në disa njësi organizative, të cilat ndihmojnë në realizimin e misionit dhe funksioneve të saj. Këto njësi organizative organizohen dhe funksionojnë sipas parimit të unitetit, hierarkisë dhe llogaridhënies. Çdo njësi organizative i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe drejtimit nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në të njëjtën kohë, në mbështetje të nenit 204, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë përfaqëson Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në marrëdhënie me të tretët.</p> <p>Vendimet e marra nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë akte administrative, të cilat hartohen dhe dalin në bazë të një procedurë të mirëfilltë administrative sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative dhe në ushtrim korrekt të autoritetit të dhënë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar dhe ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar për të nxjerrë aktin administrativ, si dhe njoftimin e subjekteve të interesuara.</p> <p>Në zbatim të parashikimeve të neneve 204, pika 1, shkronja “j”, dhe 214, pika 7, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, shqyrton projektvendimin e inspektorit duke verifikuar respektimin e kërkesave lidhur me formën, plotësinë e përmbajtjes, përkimin e vendimit me praktikën e punës të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë e të gjykatave dhe vendos miratimin, kthimin e projektvendimit me propozimin për të bërë korrigjimet dhe plotësimet e nevojshme, ose ndryshimin e projektvendimit.</p> <p>Në të njëjtën kohë, zyrtarët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbartin detyrimin për të garantuar paanësinë në çdo vendimmarrje, pasqyruar kjo në një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore me detyrime ligjore specifike për të deklaruar dhe shmangur çdo pengesë ligjore apo situatë konflikti interesi. Këto akte ligjore dhe nënligjore janë të njohura dhe të detyrueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e veçanërisht inspektorët që trajtojnë ankesa apo realizojnë hetime disiplinore.</p> <p>Në kuadër të parimit të transparencës, ju bëjmë me dije që në faqen zyrtare të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë të publikuar emrat e inspektorëve të atashuar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Drejtësisë. Pretendimet ndaj secilit inspektor që lidhen me papajtueshmërinë apo pengesat ligjore për kryerjen e detyrës gjatë një procedure administrative, bashkë me dokumentacionin që dispononi, mund t'i dërgoni pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vijuar me shqyrtimin e pretendimeve tuaja.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mbetet i përkushtuar ndaj respektimit dhe angazhimit të zbatimit të parashikimeve kushtetuese, kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, për të respektuar dhe garantuar trajtim të paanshëm e objektiv në përmbushje të funksionit të rëndësishëm.</p>		
51	17.03.2026	Kërkesë për informacion lidhur me një platformë elektronike që nuk menaxhohet nga ILD z. E.K (Orientim mbi kompetencën)	24.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, mbërritur me anë të postës elektronike pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe regjistruar me nr. 837/2 prot., datë 17.03.2026, përmes së cilës kërkonti informacion lidhur me platformën e-Albania, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Në përmbajtje të kërkesës suaj nuk ngrihen pretendime mbi veprimtarinë e ndonjë magjistrati, sikurse parashikohet në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nisur nga parashtrimi i mësipërm në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesën tuaj, ju orientojmë që në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi t’i drejtoheni organeve kompetente, në rastin tuaj Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.</p>		
52	17.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesave të paraqitura nga shtetasja znj. G.P	24.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 856 prot., datë 17.03.2026, përmes së cilës kërkoni informacion se në cilën fazë ndodhet ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se:	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Sikurse jeni njoftuar bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesat tuaja janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kriterëve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuara në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>		
53	18.03.2026	Kërkesë për informacion drejtuar një institucioni tjetër për dijeni ILD nga z. G.GJ (Orientim mbi kompetencën)	24.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 256/2 prot., datë 18.03.2026, përmes se cilës i drejtoheni Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e</p>		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.</p> <p>Në përmbajtje të kërkesës tuaj nuk ngrihen pretendime mbi veprimtarinë e ndonjë magjistrati, sikurse parashikohet në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nisur nga parashtrimi i mësipërm në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesën tuaj, ju orientojmë që në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi t’i drejtoheni organeve kompetente, sikurse del qartë nga kjo kërkesë që i jeni drejtuar.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.</p>		
54	19.03.2026	Kërkesë për informacion mbi	27.03.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		ecurinë shqyrtimin ankesës të paraqitur nga shtetasi z. L.B		<p>3/6 prot., datë 19.03.2026, përmes së cilës ngrini pretendime se nuk keni marrë përgjigje në lidhje me ankesën tuaj, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Për çdo kërkesë për informacion të depozituar nga ana juaj në vitin 2026, keni marrë përgjigje me shkresat nr. 3/1 prot., datë 08.01.2026, nr. 3/3 prot., datë 09.02.2026 dhe nr. 3/5 prot., datë 10.03.2026, në të cilat ju është bërë me dije se ankesa me nr. 324 prot., datë 06.02.2025, bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Sikurse ju kemi vënë në dijeni në shkresat e sipërcituara, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>		
55	24.03.2026	Kërkesë për informacion lidhur me një kallzim penal që nuk është në kompetencë të ILD, nga z. S.G (Orientim mbi kompetencën)	27.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 906 prot., datë 24.03.2026, përmes së cilës kërkon kopje dhe dokumentacionin shoqërues të vendimit penal me nr. 355, datë 11.02.2020, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.</p> <p>Në përmbajtje të kërkesës tuaj nuk ngrihen pretendime mbi veprimtarinë e ndonjë magjistrati, sikurse parashikohet në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nisur nga parashtrimi i mësipërm në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesën tuaj, ju orientojmë që në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi t’i drejtoheni organeve kompetente, sikurse del qartë nga kjo kërkesë që i jeni drejtuar.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

56	25.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesave të paraqitura nga shtetasi z. L.A	01.04.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, të mbërritur me anë të postës elektronike dhe të regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 487/4 prot., datë 25.03.2026, përmes së cilës kërkonti informacion lidhur me trajtimin e ankesave tuaja, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Sikurse jeni njoftuar në vijimësi, bazuar në nenin 121, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesat nr. 1848 prot., datë 18.02.2025, nr. 3499 prot., datë 09.12.2025, nr. 3500 prot., datë 09.12.2025, nr. 3502 prot., datë 09.12.2025, nr. 3503 prot., datë 09.12.2025, nr. 3505 prot., datë 09.12.2025, si dhe nr. 335 prot., datë 30.01.2026, janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuar në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>	Përfunduar	Nuk ka
57	25.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimin ankesës të paraqitur nga shtetasi z. E.D	02.04.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të mbërritur përmes postës elektronike dhe të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 924 prot., datë 25.03.2026, nëpërmjet së cilës kërkonti informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat juaj, ju vëmë në dijeni se:</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesa juaj ndodhet në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të ankesave të depozituara prej disa vitesh nga qytetarët, institucionet publike dhe personat juridikë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë respekton një metodologji të miratuar për shqyrtimin e çdo ankese, sipas kriterëve që lidhen me datën e dorëzimit, fazën e trajtimit, tipologjinë, apo urgjencën e trajtimit edhe në funksion të parashkrimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t’ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuara në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>		
58	27.03.2026	Kërkesë për informacion mbi ecurinë shqyrtimit ankesës të paraqitur nga znj. R.Gj	02.04.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj të mbërritur përmes postës elektronike dhe të regjistruar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 946 prot., datë 27.03.2026, nëpërmjet së cilës kërkonte informacion se në cilën fazë ndodhen ankesat tuaja, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Bazuar në nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankesat tuaja me nr. 765 prot., datë 06.03.2026, nr. 794</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>prot., datë 10.03.2026 dhe nr. 765/2 prot., datë 19.03.2026 janë në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit.</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, do t'ju njoftojë në vijimësi për çdo vendim, që do të merret, sipas afateve të parashikuara në nenin 119, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p>		
59	30.03.2026	Kërkesë për informacion lidhur me një efektiv policie që nuk është në kompetencë të ILD, nga z. A.B (Orientim mbi kompetencën)	03.04.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, mbërritur me anë të postës elektronike pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe regjistruar me nr. 953 prot., datë 30.03.2026, përmes së cilës ngrini pretendime mbi veprimtarinë e A.T., efektiv policie, ju vëmë në dijeni se:</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.</p> <p>Në përmbajtje të kërkesës suaj nuk ngrihen pretendime mbi veprimtarinë e ndonjë magjistrati, sikurse parashikohet në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i</p>	Përfunduar	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>ndryshuar. Nisur nga parashtrimi i mësipërm në funksion të zgjidhjes së çështjes dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesën tuaj, ju orientojmë që në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi t'i drejtoheni organeve kompetente, në rastin tuaj Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP).</p> <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh gatishmërinë maksimale të verifikojë dhe shqyrtojë ankesat e paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, për subjektet e parashikuara në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Për informacione të detajuara, mund të klikoni mbi linkun: https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/ ose të vizitoni faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë www.ild.al.</p>		
--	--	--	--	--	--